

Në pajtim me Programin për financim të projekteve për zhvillimin e zejtarisë, hotelarisë dhe tregtisë të Qytetit të Shkupit për vitin 2021 ("Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 16/20), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për subvencionimin e zejtarëve në qytetin e Shkupit për furnizimin e veglave dhe repro
- materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje për vitin 2021

1. Lënda e thirrjes publike është subvencionimi i zejtarëve për furnizimin e veglave dhe të repro - materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në suaza të qytetit të Shkupit. Qyteti i Shkupit synon që të stimulojë zhvillimin e zejeve tradicionale që janë në zhdukje, përmes subvencionimit të zejtarëve në qytetin e Shkupit për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme përmes subvencionimit deri më 80 % të shpenzimeve të dëshmuara, por jo më shumë se 50.000 denarë.

Në pajtim me Programin për financim të projekteve për zhvillimin e zejtarisë, hotelarisë dhe tregtisë të Qytetit të Shkupit për vitin 2021 ("Lajmëtari zyrtarë i Qytetit të Shkupit" nr. 16/20) janë lejuar mjetet në shumën prej 1.000.000,00 denarë.

2. Të drejtën e pjesëmarrjes në thirrjen publike e kanë:

- Zejtarët që nuk kanë fituar mjete buxhetore nga projektet për subvencione nga burimet tjera;
- Zejtarët që janë të regjistruar në pajtim me Ligjin për realizimin e veprimtarisë zejtare ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 15/2015) dhe të cilët ushtrojnë veprimtari zejtare që janë në zhdukje, të cilët në pajtim me të dhënat e shqyrtuara manifestojnë zvogëlim të aktiviteteve në vazhdimësi: jorganxhi, opinga bërës, litar bërës, lëkurëtarë, poçar, kapela bërës, kovaç, teneqe bërës, kopsa shitës, shitës i qirinjeve, shitës i kurorave, shitës i sitave, punime të dorës – shporta, punime të dorës – suvenire, punime dore shtëpie, prodhimtari të instrumenteve muzikore dhe samarxhi.
- Zejtarët e regjistruar që posedojnë dyqanet e tyre ose dyqane me qira, që janë të lokalizuara në qytetin e Shkupit, të cilët gjatë parashtrimit të kërkesës deri te Qyteti i Shkupit për subvencionimet për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme të zejtarëve në territorin e qytetit të Shkupit për vitin 2021, do të parashtrojnë faturën ose llogarinë fiskale për veglat dhe repro - materialet e furnizuara;
- Ti kenë të paguara obligimet ndaj shtetit dhe ndaj të punësuarve;
- Të kenë filluar me punë së paku 1 (vit) para shpalljes së thirrjes publike (të jenë regjistruar në Regjistrin e zejtarëve).

3. Dokumentet e nevojshme për paraqitje:

- Kërkesa e plotësuar (që mund të merret në arkivin ose nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- Aktvendimi për regjistrimin në Regjistrin e zejtarëve, leja e zejtarisë;
- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendrorë i RMV-së, jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Vërtetimi për tatimet dhe kontributet e paguara nga Drejtoria e të ardhurave publike e RMV-së, jo më e vjetër se 3 (tre) muaj;
- Obligimet e paguara ndaj Qytetit të Shkupit (taksën komunale – taksën e firmës dhe tatimin e pronës). Kontrollimi do të realizohet përmes rrugës zyrtare në Qytetin e Shkupit.
- Deklaratën e kërkuarit se deri më tani nuk ka shfrytëzuar mjete nga burime të tjera për asnjërën prej qëllimeve;
- Llogaritë fiskale në trajtë origjinale ose faturën dhe certifikatën nga banka afariste me datën për periudhën nga 01.01-10.12.2021;

Dokumentacioni i lartpërmendur i plotësuar tërësisht të dorëzohet në trajtë origjinale ose në kopje të verifikuara te noteri.

Dokumentacionet e pa plota dhe ato të dorëzuara me vonesë, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit nga ana e Komisionit.

4. Subvencioni i shpenzimeve

- Kërkesat nga zejtarët do të shqyrtojë Komisioni për realizimin e procedurës për subvencionimin e zejtarëve për furnizimin e veglave të nevojshme dhe të repro - materialeve për zejet në zhdukje në suaza të qytetit të Shkupit, i formuar nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit. Përzgjedhja e kërkuesve të cilët do të plotësojnë kushtet e përcaktuara me Thirrjen publike, do të realizohet duke respektuar parimin “i pari i paraqitur, i pari i shërbyer”, përkatësisht duke respektuar radhitjen e parashtrimit të kërkesave, deri në përfundimin e mjeteve në janë në disponim.
- Pas zgjedhjes së kërkuesve, do të pasojë miratimi i aktvendimit nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit, me të cilin do të miratohet kërkesa për subvencionim të zejtarëve për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në suaza të territorit të qytetit të Shkupit. Me miratimin e aktvendimit, Qyteti i Shkupit obligohet që të subvencionojë deri më 80 % nga shpenzimet e dëshmuara, por jo më shumë se 50.000 denarë për subvencionime pas parashtrimit të Kërkesës për pagesën e mjeteve me dëshmitë e parashtruara financiare nga ana e kërkuesit.
- Do të subvencionohen vetëm shpenzimet e dëshmuara për qëllimet e parapara, që janë manifestuar në suaza të periudhës së përcaktuar 01.01-10.12.2021.
- Një kërkues, mund të shfrytëzojë subvencione vetëm një herë pas shpalljes së thirrjes publike.

Thirrja publike është shpallur edhe në ueb faqen e internetit www.skopje.gov.mk

Parashtrimi i fletë aplikimit në trajtë të letrës

Kërkesa për subvencionimin të zejtarëve për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në suaza të qytetit të Shkupit me të gjitha dokumentet duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: **Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bul. “Ilinden” nr. 82 Shkup** (me shënimin – Paraqitja për thirrjen publike për subvencionim të zejtarëve për furnizimin e veglave dhe repro materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në suaza të qytetit të Shkupit), **më vonë deri më 10.12.2021.**

Parashtrimi i fletë aplikimit përmes postës elektronike

Kërkesa për subvencionimin të zejtarëve për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në suaza të qytetit të Shkupit me të gjitha dokumentet e theksuara në kërkesën, duhet të dorëzohen të skenuar në linkun vijues: aplikacii.skopjelab.mk/zanaetcii , **më vonë deri më datën 10.12.2021.**

Në rast të përfundimit të mjeteve të parapara financiare, Qyteti i Shkupit do të shpall përfundimin e Thirrjes publike përmes ueb faqes së sajë.

Pagesa e mjeteve të lejuara, do të realizohet në mënyrë sukcesive, sipas radhitjes së kërkesave të dorëzuara sipas parimit “I pari i paraqitur, i pari i shërbyer”, dhe pas miratimit të aktvendimeve për miratim të kërkesave nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit, kurse në rastet e mos pranimit të kërkesës, parashtruesi me shkrim njoftohet për mos miratimin. Komisioni i njofton kërkuesit nëse të njëjtët posedojnë dokumentacionet e parregullta dhe të pa kompletuara dhe ua kthen të njëjtat si shtojcë e njoftimit.

Kërkesat për subvencionim të zejtarëve për furnizimin e veglave dhe repro - materialeve të nevojshme për zejet në zhdukje në qytetin e Shkupit mund të merren në Arkivin e Qytetit të Shkupit, Seksioni për zejtari, hoteleri dhe tregti dhe në ueb faqen www.skopje.gov.mk.

Pyetjet për sqarime plotësuese mund të dorëzohen me shkrim ose në trajtë elektronike deri te Sektori për zhvillim ekonomik lokal.

Kontakt tel: (02) 3297 284, www.skopje.gov.mk, adresa e e - mailit: Fevzi.Mani@skopje.gov.com dhe Biljana.Stojmanovska@skopje.gov.mk

QYTETI I SHKUPIT